



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET

"HAXHI ZEKA"

MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR

RISKU KREDITOR KAPITULLI 5



Prof. Asoc. Dr. Ibish Mazreku

Ph.D. (c) Fisnik Morina

MARS, 2018

4/4/2018

RISK

A probability or threat of damage, injury, liability, loss, or any other negative occurrence that is caused by external or internal vulnerabilities, and that may be avoided through preemptive action



HYRJE NË RISKUN KREDITOR

3

- Analiza e rrezikut të kredisë përfshin komponentë të ndryshëm që, në kombinim, i ofrojnë bankës mënyrën për ta matur probabilitetin që një huamarrës të **dështoi në përmbushjen e një kontrate - një borxhi, kredie, ose një premtimi të ngjashme për ta kryer** - dhe se sa vlerë ka të ngjarë që do të mbulohet në rast të dështimit.
- Rreziku i kredisë më thjeshtë definohet si potencial që një huamarrës ose pala tjetër, do të dështojnë për ti përmbushur detyrimet e tij në përputhje me kushtet e rëna dakord.
- Mospagimi është dështimi për të shlyer ose për ti përmbushur detyrimet ekzistuese.

- Rreziku i kundërpalës është një referencë e përbashkët me rrezikun që një palë tjetër në një kontratë ose marrëveshje do të dështojë për të performuar sipas kushteve të marrëveshjes.
- Kjo mund të thotë dështimin për të ofruar mallrat ose shërbimet e premtuara, një refuzim për ti siguruar lehtësirat e premtuara të kredisë, ose dështimi për të paguar shuma që detyrohet.

HUADHËNËSIT

- Bankat lehtësojnë ndërmjetësimin financiar, procesi me të cilin një grup në nevojë për kapital merr hua fonde nga një grup tjetër që ka kapitalin e tepërt në dispozicion për investime.
- Bankat pranojnë depozita nga një grup (depozituesit) dhe i përdorin këto fonde për të ofruar produkte të kreditit një grupi tjetër (huamarrësit).
- Dhënia e kreditit (dmth, kredisë) krijon rrezikun. Bankat e pranojnë këtë rrezik si një kosto të rregullt të biznesit.
- Në thelb, bankat janë në biznesin e menaxhimit të rrezikut.
- Bankat vazhdimisht përpiqen për të zgjeruar aftësinë e tyre për të menaxhuar të gjitha llojet e rreziqeve dhe, në veçanti, kanë fituar përvojë të konsiderueshme me analizën e rrezikut të kredisë.

- Bankat në mënyrë rutinore vlerësojnë përvojat e tyre dhe përfshijnë mësimet e nxjerra në praktikën e biznesit të tyre duke modifikuar ose shtuar politikat dhe procedurat për të zbutur rrezikun e kredisë.
- Përkundër këtyre përpjekjeve, ngjarjet e fundit në sektorin bankar kanë nxjerrë në pah se sa sfiduese mund të jetë analiza e kreditit dhe e menaxhimit të rrezikut të kredisë.
- Bankingu është thelbësorë për tregjet me pakicë dhe tregjet me shumicë.
- Ka mijëra banka lokale, rajonale dhe globale që ofrojnë një shumëllojshmëri të produkteve dhe shërbimeve për të përmbushur nevojat e tregut me pakicë

Banka me pakicë

Banaka me shumicë

Konsumatorët përfshijne

- Individët/Dyqantë
- Bizneset e vogla

Konsumatorët përfshijne

- Bankat tjera/Korporatat e mëdha
- Institucionet e mëdha globale

. Llojet kryesore të bankave

BANKAT INVESTIMEVE

- Bankat e investimeve shpesh veprojnë si agjent ose ndërmjetës financiar për kompanitë.
- Edhe pse ata mund të kenë operacionet e tyre brokerimi, japin këshilla për investime për klientët e tyre, dhe ofrojnë hua dhe kredi për konsumatorët komercial, aktiviteti i tyre kryesorë është të aranzhojnë ekuitetin dhe financimin e borxhit në emër të klientëve të tyre korporative.
- Bankat e investimeve zakonisht nuk pranojnë depozita nga klientët apo të japin kredi për konsumatorët me pakicë, dhe ato shpesh nuk rregullohen drejtpërdrejt nga rregullatorët e bankave nëse banka e investimeve është pjesë e një banke që përndryshe është rregulluar nga rregullatorët e bankës.

HUAMARRËSIT

- Të dyja bankat me pakicë dhe shumicë dallojnë midis llojeve të ndryshme të huamarrësve në bazë të një sërë faktorësh, duke përfshirë madhësinë dhe të nevojave për financim.
- Në anën e shitjes me pakicë, një ndryshim i gjerë është bërë në mes të huamarrësit individual dhe huamarrësit biznes i vogël.
- Në anën e shitjes me shumicë, megjithatë, dallimi është më kompleksë.

HUAMARRËSIT ME PAKICË (RETAIL BORROWERS)

- Huamarrësit me pakicë përfshijnë konsumatorët (individët) që marrin hua para për të blerë shtëpi, makina, dhe mallra të tjera (në shumë vende, konsumatorët marrin hua për të financuar arsimin dhe shpenzime të ngjashme).
- Në përgjithësi, konsumatorët me të ardhura të larta, me nivele të ulëta të borxhit, si dhe me të dhëna solide të shlyerjes së kredisë konsiderohen si huamarrës më pak të rrezikshëm, por rejtimi i një huamarrësi në fund të fundit varet nga një sërë kriteresh.
- Çdo bankë ka zhvilluar politikën e vendimmarrjes për krediti që përshkruajnë se çfarë lloje të madhësisë-kredisë, ekspozimit, dhe biznes-nevojën për ta aprovuar ose ratifikuar nga menaxhmenti i lartë dhe/ose komiteti i bordit të bankës.

HUAMARRËSIT KORPORATIV

- Huamarrësit korporativ përfshijnë kompanitë duke filluar nga kompanitë e vogla lokale deri të konglomeratet e mëdha globale.
- Secili ka nevoja të ndryshme të financimit, dhe secili duhet të analizohet në një bazë të veçuar. Në varësi të lehtësisë se qasjes në kapital (tregjet publike, bankat, financimi private), kompanitë mund të marrin hua kapital ose të rrisin ekuitetin për të financuar rritjen dhe të gjenerojë të ardhura.
- Kur marrin hua, kompanitë në mënyrë tipike i shlyejnë detyrimet e tyre nga keshi i gjeneruar nga rritja.
- Kompanitë me fitime të qëndrueshme, nivel të ulët të borxhit, si dhe menaxhimin solide konsiderohen të jenë më pak të rrezikshme dhe iu ofrohen kushte më të mira kontraktuale për huazimet e tyre.

Huamarrës	Nevojat për kapital	Struktura e pronësisë	Operacionet	Sofistikimi financiar
Kompani lokale	Nevojat e vogla dhe produkte të thjeshta krediti	Strukturë e thjeshtë e pronësisë (biznes familjar, partneritet)	Operacione të limituara në një lokacion me pak se 50 punëtorë.	E limituar. Mbështeten shumë me një bankë për këshilla financiare dhe solucione për probleme financiare.
Kompanitë rajonale	I përmbushi në nevojat substancial e me kombinimin e produkteve të thjeshta kreditore.	Disa partner apo korporatë me shumë partner. Mund të kenë disa degë. Mund të tregtohen publikisht në shkallë të limituar apo rajonale.	Operojnë me një apo me shumë lokacione, duke përfshirë operimet ndërkombëtare . Punësojnë disa qindra punëtorë.	Kane përvojë ndërkombëtare . Të aftë të kombinojnë kredinë dhe produktet tjera financiare që me se miri kënaqin nevojat e tyre. Shpesh kanë marrëdhënie multi bankare.
Kompanitë ndërkombëtare	Nevoja të mëdha, të ndryshme, që kërkojnë lloje të ndryshme produktesh bankare si dhe produkte tjera inovative financiare.	Publikisht tregtojnë në shumë bursa me numër të madhe pronarësh (aksionarë). Kanë degë multinacionale për rrethë botes.	Multinacionale me biznes rrethë botes. Punësojnë me mijë njerëz.	Me sofistikim të lartë. Punësojnë staf që fokusohen në alternativa të financimit për kompaninë. Kane marrëdhënie me shumë banka por me një bankë lider.
Kompanitë universale	Nevoja të mëdha, të	Tregtohen publikisht në	Me biznese multi rreth	Shumë të sofistikuar. Të

HUAMARRËSIT SOVRANË

- Huamarrësit sovranë janë qeveritë që rrisin kapitalin nëpërmjet obligacioneve ose huamarrjes së drejtpërdrejtë kryesisht nga bankat më të mëdha globale.
- Shumat e ngritura përdoren shpesh për investime të mëdha kapitale (rrugët, hekurudhat) ose për të financuar shpenzimet qeveritare.
- Qeveritë shpesh përdorin të ardhurat nga taksat për të shlyer këto kredi.

KARAKTERISTIKAT E PRODUKTEVE TË KREDISË

- Ka një shumëllojshmëri të gjerë të llojeve të kredisë.
- Të gjithë janë zhvilluar për të përmbushur nevojat specifike të biznesit të huamarrësve të ndryshëm në situata unike.
- Për të kuptuar se cili lloj i kreditimit është e përshtatshme për një huamarrës, huadhënësit duhet të kuptojnë hollësitë e gjendjes financiare të huamarrësit, sidomos si lidhet me kushtet ekzistuese dhe të parashikuara në tregjet lokale, rajonale apo ndërkombëtare.

Ka një numër mënyrash se si produktet e kreditit mund të klasifikohen.

- Maturimi
- Specifikim i zotimit
- Qëllimi
- Burimet e ripagimit
- Kërkesat për kolateral
- Kërkesat e zotimeve
- Karakteristikat e ripagimit.

Kategoria	Kreditimi afat-shkurt	Kreditimi afat-mesëm	Kreditimi afat-gjatë
Afati maturitetit	Më pak se 12 muaj	1 deri 5 vite	Më shume se 5 vite
Shfrytëzimi tipik	I shfrytëzuar për nevoja te përkohshme apo sezonale	Kryesisht shfrytëzohet për financimet ne vijim për makineri apo për mbështetjen e projekteve afat shkurtër, por jo për investime kapitale. Ky lloj financimi gjithashtu i plotëson nevojat ciklike dhe investimet e kësaj natyre nuk pritet te gjenerojnë kesh ne periudhe te shkurtër.	Ofrojnë financime për nevojat afat gjate. Ky lloj i kredisë do te financoi ndërtimet ne projektet e mëdha kapitale. Keshi i gjeneruar nga pajisjet e reja, produktet, apo aktivitetet është burim primare për riparim.
Shembull	Prodhuesi i lodrave pret se do te rriten nevojat e tij për kredi gjate verës se hershme kur kompania blen lenden e pare për rritjen e prodhimit për fund te sezonës se pushimeve te verës. Paraja e huazuar do te ripaguhet nga keshi qe do te grumbullohet nga shitjet.	Prodhuesi i lodrave gjithashtu ka nevoje te blej makineri dhe pajisje për procesin prodhues. Këto asete do te kenë një jete te pritshme prej 3 deri 4 vite dhe do te kontribuojnë qe te prodhohen mallrat. Blerja e këtyre aseteve e rrisin kapacitetin prodhues, por financimi i makinerisë do te kërkoi përputhjen e fondeve për 4 vite, qoftë te bazuar ne	Ashtu si rritet biznesi, kompania ka vendosur te ndërtoi një fabrike te re ne pjese te ndryshme te botes. Ndërtimi i fabrikës se re dhe blerja e makinerisë se re është dukshëm e shtrenjte, dhe për ti financuar këto shpenzime, bankat zakonisht ofrojnë financim afatgjate i cili duhet te ripaguhet nga te ardhurat e gjeneruar nga zgjerimi apo qe

LLOJET E PRODUKTEVE TË KREDITIT

17

- KREDITË BUJQËSORE
- KREDITË TË SIGURUAR BAZUAR NË ASETE
- KREDITË PËR AUTOMJETE
- LETRAT KOMERCIALE
- BONDET E KORPORATAVE
- OBLIGACIONET ME MBULESË
- FAKTORINGU
- LIZINGU
- HIPOTEKAT
- FACILITETI OVËRDRAFT
- LINJAT E KREDITIT PËR ASETE NË SHTËPI APO ASETE SHTËPI KREDITË
- FINANCIMI I INFRASTRUKTURËS APO PROJEKTEVE
- LINJA RROTULLUESE (REVOLVING) E KREDITIT
- KREDITË SINDIKATE

PROCESI KREDITOR

- Analiza e kredisë apo vlerësimi i kreditit është procesi i vlerësimit të rrezikut e matur me aftësinë e huamarrësit për të shlyer kredinë.
- Në kuadër të procesit të analizës ose te vlerësimit të kreditit, analisti do të marrë në konsideratë rimëkëmbjen e mundshme në rast të vonesës dhe do të vlerësojë mbështetjen e kolateralit dhe mjeteve të tjera mbështetëse të kredisë që ndikojnë në vendimin përfundimtar të bankës për të zhvilluar një marrëdhënie kreditore.
- Pasi qe vlerësohet aftësia e ripagimit, vendimi për të aprovuar kredinë më pas, është një vendim komercial




IDENTIFIKO MUNDË KRE NDESINË E KREDIT DINË	EVALUO KREDIT MARRESIN PERSPEKTIV	MERR VENDIM KREDITORE	DISBURSO KREDIT INE	MONITORO DINË
-SHIKO MUNDË PERFORMANCË E REJA FINANCIAR	-RISHIKO RISKUN E BIZNESIT	-VENDIMI I OFICERIT KREDITOR	-MARREVESHJA LI GJORE	-MONITORO PERFORMANCEN
-BENI KONTAKT. HUAMARRËSIT ME HUAMARRËSIN PERSPEKTIV	-RISHIKO RISKUN FINANCIAR STRUKTURAL	-VENDIMI MENAXHMENTIT BORDIT KREDIT TE MEDHA	-VEJA PARAT NE DISBURS SPOZICINON TE HUAMARRËSIT	-MONITORO PERFORMANCEN E HUAMARRËSIT

Hapat ne procesin kreditor

PROCESI I ANALIZIMIT TË KREDISË

20



RRUGA E ANALIZËS SË KREDISË

21

RREZIQET E BIZNESIT		RREZIQET FINANCIARE		RREZIQET STRUKTURE	
Analiza makroekonomike huamarresit	Analiza mikroekonomi. huamarresit	Analizae Menaxhmentit	Analiza Financiare	Lloji i Financiare	Lloji i Huamarresit
Shembuj: -GDP	Shembuj: Trendet ne industri	Shembuj: Proaktiv reaktiv	Shembuj: Pozicioni operativ financiar	Shembuj: Kompani holding	Shembuj: I sigurt I pa sigurt
-Inflacioni	Trendet rregullative	Strategjia Motivacioni	Shpalosja financiare	Subsidiari operativ primare	Afatgjate Afatshkurter
-Trendet demografike		Eksperienca		Subsidiari sekondar	Subordinuar
-Cikli biznesor		Integriteti		opertaiv	
-Stabiliteti politik		Qeverisja korporatave			
-Ambienti rregullativ					
-Ambienti Ligjore					

RREZIQET E BIZNESIT

Ambienti ekonomik

Cikli biznesore

Trendet ne industri

dhe ne rregullatorit
gjenero

Risku politik

Qeshtjet sociale

RREZIQET FINANCIARE

Strategjia dhe aftësia e

menaxhmentit

Integriteti i menaxhmentit

Struktura organizative e

e kompanise

Sistemet e kompanise

Performanca operative dhe

financiare e kompanise

RREZIQET STRUKTURORE

Qeshtja struktures

(sigurt/pasigurte, maturiteti,

marrëveshjet etj.)

Marredheniet e grupit (ku

het keshi dhe ku eshte ekspozimi)

Risku i biznesit, financiar dhe strukture

SWOT ANALIZA

23

INTERNE



ANET E FORTA

Shembull:

- rrjedha e fuqishme e paras se gatshme e brendshme
- Menaxhmenti kompetent

ANETE E DOBETA

Shembull:

- pamundesia e zgjerimit te shpejt te prodhimit per te kenaqur kerkesesat
- Veshtir. per te sigur. staf te kual.

EKSTERNE



MUNDESITE

Shembull:

- Industria me rregullim te larte paraqet barrier hyrese per konkurrent te rinje.
- Kerkesa ne rritje per produktet e kompanive

KERCENIMET

Shembull:

- Ekonomia ne stagnim
- Normat e larta te interest dhe rritja e inflacionit

BURIMET E INFORMACIONIT

- Ka shumë burime të ndryshme të informacionit që përdoren në procesin e vlerësimit të kreditit.
- Një burim i rëndësishëm është raporti vjetor të kompanisë dhe pasqyrat e saj financiare të audituara.
- Pasqyrat financiare të kompanisë zakonisht auditohen ose vlerësohen në mënyrë të pavarur nga ekspertë kontabël të jashtëm të cilët e shqyrtojnë informacionin financiar të kompanisë për të certifikuar se a janë në pajtim me parimet e përgjithshme të pranuar të kontabilitetit të një vendi (GAAP), ose në kuadër të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

- Është e rëndësishme të theksohet se prodhimi dhe sigurimi i këtij informacioni për analistët kreditorë nuk do të parandaloi kompanitë nga të angazhohen në aktivitete të dyshimta apo mashtruese.
- Megjithatë, informacioni shërben si një kontroll mbi menaxhimin e kompanisë, si dhe analiza e pasqyrave financiare të audituara siguron një nivel të arsyeshëm, edhe pse jo të plotë, të rehatisë për investitorët potencialë dhe bankierët.
- Shënim, megjithatë, në shumicën e vendeve bizneset e vogla nuk nevojiten që të kenë pasqyrat e tyre financiare të audituara në mënyrë të pavarur, dhe analistët e kredisë duhet për të formuar gjykimin e tyre të pavarur në saktësinë e llogarive.

PËRFUNDIMI I KAPITULLIT TË V-të

